VENDIM
Nr.138, datë 1.11.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.130, DATË 22.10.2007 "PËR PËRBËRJEN E KOMISIONIT HETIMOR "PËR HETIMIN E OBJEKTIT DHE PROCEDURAVE TË KONTRATËS SË PRIVATIZIMIT TË ALBTELEKOMIT PËR PERIUDHËN 2001 E NË VIJIM""

Në mbështetje të nenit 77 pika 2 të Kushtetutës, të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit" dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e grupeve parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Deputeti Gëzim Musabelliu zëvendëson deputetin Albert Divjaka në Komisionin Hetimor "Për hetimin e objektit dhe procedurave të kontratës së privatizimit të Albtelekomit për periudhën 2001 e në vijim".

II. Deputetja Ermelinda Meksi zëvendëson deputetin Stefan Çipa në këtë Komision.

III. Deputeti Paskal Milo zëvendëson deputetin Dritan Prifti në këtë Komision.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)